



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E VLERËSIMIT DHE E ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I LIRIMIT

SESIONI I

E hënë 7 qershor 2010

Ora 10.00

Lënda : Gjuhë shqipe

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **25 kërkesa**.

Trembëdhjetë kërkesa janë me zgjedhje, ku do të rrethoni vetëm shkronjën përbri përgjigjes së saktë. Kërkesat e tjera janë me zhvillim dhe për secilën është dhënë edhe hapësira e nevojshme, ku do të shkruani përgjigjen.

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është 2 orë e 30 minuta.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim vetëm nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10a	10b	11a
Pikë												
Kërkesa	11b	12a	12b	12c	13	14a	14b	15	16a	16b	17a	17b
Pikë												
Kërkesa	18	19	20a	20b	21a	21b	22a	22b	23a	23b	24	25a
Pikë												
Kërkesa	25b	25c	25d									
Pikë												

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1..... Anëtar

Nota

2. Anëtar

PJESA I

Lexoni pjesën e mëposhtme, pastaj përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Pse luajmë

Pse luajmë lojëra të ndryshme? Sepse ato janë pjesë e jetës sonë dhe e bëjnë atë më të bukur, më të këndshme. Por ka edhe shumë e shumë arsye të tjera. Pa dyshim çdo lojë ka rregullat e veta, të cilat duhet t'i njohësh, t'i zbatosh, të dish si të veprosh gjatë gjithë lojës dhe të jesh pjesë e moshatarëve me të cilët luan. Të gjitha këto lidhen me idenë e “lojës” që ju do të “ndesheni” gjatë gjithë jetës suaj.

Mendoni për një çast të gjitha lojërat që keni luajtur kur keni qenë të vegjël, si *kukamshefti*, *lojë me peta*, *ngriva- shkriva* etj. Janë lojëra të hershme, shumë shekullore që janë luajtur e luhen nga fëmijët e mbarë botës.

Lojërat në vende dhe kultura të ndryshme janë gazmore dhe zbavitëse. E rëndësishme është se ato e transformojnë jetën në ndodhi mbresëlënëse; fëmijët bëhen më të shkathët, më të guximshëm dhe më të vendosur për të arritur fitoren. Për më tepër lojërat të mësojnë disa rregulla, që duhen zbatuar dhe sidomos të mësojnë si të bashkëveprosh me shokët e tu të grupit.

Shpesh lojërat edukojnë te fëmijët aftësi praktike, si forcën, kurajën, rezistencën ndaj kushteve të mjedisit, që do t'u duhen atyre kur të rriten. Për shembull, dihet se në Arabinë Saudite ka fëmijë jetojnë në thellësi të shkretëtirave. Ata luajnë një lojë quhet “kockat”, e cila mpreh vështirimin e tyre aq të nevojshëm për gjueti kur të rriten.

Shumë sporte nxisin krenarinë kombëtare. Lojërat më të famshme, siç janë ato Olimpikë, mbledhin atletë nga e gjithë bota. Ato kthehen në manifestime të bukura sportive dhe shpalosin paqen dhe mirësinë mes popujve. Spektatorët valëvisin flamuj, përshëndesin të gjithë rekordmenët; ata e dinë se çdo medalje ari është një fitore e bukur si për atletin ashtu edhe për vendin nga ka ardhur ai.

Një nga imazhet më prekëse të lojërave është kur sheh atletin në podium, teksa mban medaljen e artë. Luhet himni kombëtar i vendit të tij dhe të gjithë spektatorët ngrihen në këmbë në shenjë nderimi. Për vendet, të cilat kanë kaluar katastrofa natyrore apo kanë qenë në luftë, një fitore olimpikë ka një kuptim shumë të thellë.

Sportet janë ngjarje të mëdha që bashkojnë popujt. Futbolli është sot sporti më popullor në botë. Njerëzve në të gjitha kontinentet u pëlqen të luajnë – disa për zbavitje e të tjerë për të jetuar. Ka njerëz që kanë zbuluar një mënyrë për të përhapur *shpresën* përmes lojës së futbollit. Grupe të tilla si “*Të luash për paqe*” dhe “*E drejta për të luajtur*” u krijojnë mundësi edhe atyre fëmijëve, që nuk e kanë pasur kurrë shansin dhe mundësinë, që të luajnë futboll apo lojëra të tjera me top.

Herën tjetër kur të luani një lojë të thjeshtë apo të merrni pjesë në një ndeshje sportive, mendoni pak se përse u pëlqen ajo. Çfarë aftësish ju duhen për të spikatur e për të qenë më i miri në sportin tuaj të preferuar? A mendoni se këto aftësi do t'ju ndihmojnë në jetën tuaj të përditshme? Dhe mbi të gjitha, herën tjetër kur të luani, argëtohuni, sepse dita juaj do të bëhet edhe më e bukur!

1. Cila nga aftësitë e mëposhtme për të luajtur një lojë **NUK** është përmendur në pjesën e mësipërme?

1 pikë

- A) Të ndjekësh rregullat.
- B) Të planifikosh një lëvizje.
- C) Të veprosh si anëtar skuadre.
- D) Të mësosh të humbasësh me dinjitet.

2. Sipas artikullit, fitorja në Lojërat Olimpike mund të jetë frymëzuese veçanërisht për vendet:

1 pikë

- A) që janë të pasura.
- B) që janë të industrializuara.
- C) që janë duke zgjedhur një udhëheqës të ri.
- D) që janë duke përjetuar katastrofa të ndryshme.

3. Autori thekson se lojërat “*e transformojnë jetën në ndodhi mbresëlënëse*”.

Kjo do të thotë se lojërat:

1 pikë

- A) i lejojnë njerëzit të bëhen dikush tjetër.
- B) mund t'i bëjnë më interesante aftësitë që fitojmë për jetën.
- C) mund të ndryshojnë pikëpamjet e njerëzve për ngjarjet sportive.
- D) i mësojnë fëmijët të jenë më seriozë për jetën e tyre.

4. Lexoni këtë fjali nga artikulli:

Një nga imazhet më prekëse të lojërave është kur sheh atletin në podium, teksa mban medaljen e artë.

Në këtë fjali fjala *prekëse* ka kuptimin:

1 pikë

- A) e zakonshme
- B) gazmore
- C) emocionale
- D) e bukur

5. Bazuar në informacionin e dhënë në këtë artikull, lexuesi mund të parashikojë se:

1 pikë

- A) lojërat do të vazhdojnë t'i ndihmojnë fëmijët të fitojnë aftësi të rëndësishme.
- B) për shkak të konflikteve, në Lojërat Olimpike do të marrin pjesë më pak vende.
- C) grupe si “*Të luash për paqe*” do të fillojnë të shkojnë në shtete më të pasura.
- D) lojërat në natyrë do të jenë më pak popullore, për shkak të përhapjes së kompjuterëve.

6. Lexoni me kujdes këtë fjali të shkëputur nga pjesa e dhënë më sipër: *Shumë sporte nxisin krenarinë kombëtare*. Shkruani dy argumente që e mbështesin këtë pohim.

2 pikë

- a) _____
- b) _____

PJESA II

Lexoni historinë e mëposhtme, pastaj përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

DY SHOKËT

Gjatë pushimeve të verës, në lojë e sipër me shokët, Fani ka thyer këmbën. Shoku i tij, Budardi, i shkon rregullisht për vizitë në shtëpi, që tjetri të mos e ndiejë veten të braktisur.

- As ia vlen të flasim për këtë gjë, Budard. Shpejt, ke për të parë po s'u shërova; nuk ndodhi aspak për fajin tënd! Kur pushimet po mbaronin, ne të gjithë sikur po shkallonim... Askush nuk ka pse bëhet me faj.

Fani gjendej në dhomën e vet, nderur mbi shezlong dhe Budardi i qëndronte te koka. Një zjarr bubulak përskuqte tërë vatrën, duke përhapur një ngrohtësi për zili mes një zhaurime të mbytur... Ishte e enjte. Karrocet e tregut zunë rrokullimën përgjatë rrugës. Në nëntor, nata nuk vonon të bjerë.

- Vazhdon akoma të bëjë ngricë?

- Te sahatçiu, termometri shënonte tetë gradë nën zero.

- A e bëtë rrëshqitësen te vija e ujit, para shkollës?

- E bëmë, po zoti Trusher na e mbuloi me rërë. Na u desh të bënim një tjetër, më të gjatë, te rruga e portit, ballë për ballë me shtëpinë e priftit, aty te kanali, po e ke parasysh.

- E kush rrëshqet më shumë?

Budardi nguroi një hop. Fani buzëqeshi.

- Thuaje, s'ka pse, Bytoja, apo jo?

Një çast ra heshtja. Dita ende nuk e kishte humbur zbardhëllimën e vet, teksa muzgu, me një përskuqje të lehtë, si të ngurosur, kish nisur të vishte xhamat e dritareve.

- Ta ndez dritën? – foli Budardi. – Ke qejf të luajmë me letra?

Fani tundi kokën në shenjë mohimi duke vështuar zjarrin në vatër. Butë-butë, heshtja përpiu gjithçka. Herë pas here, një urë lëshonte ndonjë rënkim, nga ku shpërthente një njollë e kaltërreme, regëtinte një sekondë, para se të shkëputej e të shuhej në çastin kur fluturonte.

- Budard...

- Urdhëro, Fan?

- Dëgjo, s'ke pse e detyron veten të vish tek unë çdo të enjte. Mbase ke qejf të shkosh të luash me shokët e tjerë. Ja, shiko Patunë. Edhe pse është im vëlla, nuk rri tërë kohën me mua. Unë, vetëm, nuk mërzhitem.

- Unë vi tek ti, se kam qejf, – tha Budardi.

Tashmë gjysmerrësira kish përpirë dhomën. Ata vazhdonin të bisedonin kokë më kokë, si dy shokë të ngushtë e të sprovuar që ishin. Po Budardi një e dy e hidhte fjalën te aksidenti që kish pësuar Fani, te

vuajtjet që iu desh të përballonte. Ndërsa Fanit ia kishte qejfi të bisedonte për shokët e klasës, të shkollës, për mbarëvajtjen e tyre në mësim, kush kishte bërë hartimin më të mirë dhe thoshte se mezi po priste të kthehej në klasë, sa të mbaronte pushimet e Vitit të Ri.

- Më mbaj pak të ngrihem, ke për të parë po s'eca!

- Do kesh dhimbje e do biesh...

- Gjë pa zarrar, nuk do të rëndo mbi këmbën e thyer.

I ranë qark dhomës. Budardi ndihej krenar që po i jepte shokut të vet për mbështetje supin e tij dhe çfarë nuk bëri tjetër për t'i ardhur në ndihmë, me një përkujdesje amtare.

- Boll me kaq. Eja të shtrihesh tani.

E mbajti Fanin me kujdes të zinte vend mbi shezlong dhe pasi e shtriu, i kërkoi si shpërblim për këtë përkujdesje:

- Më lër të të shoh një çikë këmbën!

Këmba ishte ende e brishtë, mjaft e dobësuar, e zbehtë krejt, pothuaj e mavijosur. Budardi u përkul mbi të, ia fërkoj me maja të gishtave.

- Këtu të është thyer, ë? Edhe këtu... në dy vende? O zot që desh mbete sakat! Atë ditë, kur doktori të hoqi protezat, nuk vura gjumë në sy për tërë natën. Shyqyr që ai na siguroi se këmba do të shërohej plotësisht e se ti, për pak kohë, do të jesh në gjendje të rendësh si më parë... Pa më trego Fan, një çikë, si bërtisje natën nga dhimbjet e kur i thoshe babait se edhe një i rritur të qe do të bërtiste, e jo më ti.

- Po ore, edhe një burrë të qe, do të kish bërtitur po aq sa unë! Çfarë nuk bëja, sidomos gjatë natës: shtrëngoja dhëmbët, po në të vërtetë, më dukej sikur më mbërthenin një palë darë deri në palcë të kockave, darë si të skuqura në zjarr. Dhe kur ato më mbërthenin ashtu, ia jepja ulërimës. Në ato çaste, im atë, nga dhoma përbri më thoshte: "Ç'bën kështu more, mbaje veten! E si ndryshe do tregohesh që je burrë!" Mirëpo darët sikur të nguleshin edhe më tepër, e sa të mblidhja unë veten, ia kisha dhënë ulërimës. Atëherë vinin e më ndiznin dritën në mes të natës dhe ktheheshin për të rënë prapë në gjumë. Unë, në ato çaste e ndieja veten fajtor e u thosha se edhe një burrë të qe në vendin tim, nuk do kish ndenjur pa bërtitur.

7. Cila është arsyeja që Budardi shkon te Fani?

1 pikë

- A) Ai ndihet kështu më pak fajtor para shokut që u aksidentua prej tij.
- B) Ai bisedon me Fanin për gjëra që nuk mund t'i bisedojë dot me të tjerët.
- C) Ai nuk ka se si t'i kalojë ndryshe netët e gjata të dimrit.
- D) Atij i pëlqen t'i rrijë pranë shokut në çaste të vështira.

8. Përgjatë kësaj pjese vërejmë se autori e përmend herë pas here mjedisin e jashtëm. Ai e bën këtë:

1 pikë

- A) për të krijuar kontrast midis të ftohtit jashtë dhe mjedisit të ngrohtë në dhomë.
- B) për të treguar lojërat që i argëtojnë fëmijët në dimër.
- C) për të treguar sa e lehtë është të aksidentohesh në dimër.
- D) për të na thënë se edhe njerëzit janë shpesh të ftohtë si natyra në dimër.

9. Në cilën nga alternativat e mëposhtme mbiemri është përdorur me kuptim të figurshëm?

1 pikë

- A) hartim i saktë
- B) përskuqje e ngurosur
- C) rrugë e gjatë
- D) këmbë e thyer

10.

A) Pse Fani nuk dëshiron të flasë me Budardin për aksidentin? Cila është, sipas tij, arsyeja që ai e theu këmbën?

2 pikë

B) Në një moment Budardi i kërkon Fanit të ndezë dritën, pasi po errësohet, por Fani i thotë jo. Pse ai dëshiron që të bisedojnë në gjysmerrësirë?

1 pikë

11.

A) Jeta e Fanit pas aksidentit ka ndryshuar. Zbuloni në tregim dy momente ku duket kjo.

2 pikë

- a)
- b)

B) Gjenerali në tregim dy shprehje që tregojnë përkujdesjen e Budardit kundrejt Fanit.

2 pikë

- a)
- b)

12.

A) Në fund të kësaj pjese Fani rrëfen se ndihej fajtor përpara familjes. Çfarë e shkakton ndjenjën e fajit te ai? Ç'tregon kjo për natyrën e tij?

2 pikë

- a)
- b)

- B) Marrëdhënia ndërmjet këtyre dy shokëve është e veçantë. Argumentoni se çfarë e bën atë të tillë. Mendimin tuaj mbështeteni edhe me ilustrime nga fragmenti.

3 pikë

- C) Vendosini kësaj pjese një titull tjetër me kuptim të figurshëm.

1 pikë

PJESA III

13. Fjala **gjithçka** është:

1 pikë

- A) e thjeshtë
B) e përbërë
C) e prejardhur
D) e përngjitur

14. Përcaktoni klasën e fjalëve të nënvizuara në fjalitë e mëposhtme.

2 pikë

- a) *I ranë **qark** dhomës.*

- b) ***Butë-butë***, heshtja përpiu gjithçka.

15. Qarkoni rasën e emrit të nënvizuar në fjalinë e mëposhtme.

1 pikë

*Fani tundi kokën në shenjë **mohimi**.*

- A) emërore
B) dhanore
C) rrjedhore
D) kallëzore

16.

- A) Përcaktoni llojin e përemrit në fjalinë e mëposhtme.

1 pikë

*Nuk ndodhi aspak për fajin **tënd**!*

- B) Gjeni në ç'rasë është trajta e shkurtër e përemrit vetor në fjalinë e dhënë më poshtë.

1 pikë

*Pa **më** trego Fan si bërtisje natën nga dhimbjet.*

17. Gjeni mënyrën dhe kohën e foljes së nënvizuar.

2 pikë

*Regëtinte një sekondë para se **të shkëputej**.*

- a) Mënyra:

- b) Koha:

18. Përdoreni paskajoren e foljes **luaj** në fjali me funksion qëllimor.

1 pikë

19. Përcaktoni llojin e fjalisë njëkryegjymtyrëshe.

1 pikë

Më lër të të shoh pak këmbën!

- A) Me vetë të përcaktuar
- B) Me vetë të papërcaktuar
- C) Me vetë të përgjithësuar
- D) Pavetore

20. Gjeni kryefjalën.

1 pikë

a) *Im vëlla nuk rri tërë kohën me mua.* _____

b) Qarkoni me se është shprehur ajo.

1 pikë

- A) Emër
- B) Grup emëror
- C) Përemër
- D) Mbiemër

21. Në fjalinë: *Ata vazhdonin të bisedonin kokë më kokë:*

2 pikë

a) gjeni kallëzuesin: _____ b) tregoni llojin e tij: _____

22. Ç'funktion sintaksor kryejnë fjalët e nënvizuara?

2 pikë

*Një zjarr **bubulak** përskuqte tërë vatrën, duke përhapur një ngrohtësi për zili mes një zhaurime të mbytur...*

*Ndërsa Fanit ia kishte qejfi të bisedonte **për shokët e klasës**.*

a) bubulak: _____ b) për shokët e klasës: _____

23. Gjeni në fjalinë e mëposhtme pjesën e nënrenditur.

1 pikë

Kur pushimet po mbaronin, ne të gjithë sikur po shkallonim.

a) Pjesa e nënrenditur: _____

b) Qarkoni se ç'lloj fjalie është pjesa e nënrenditur.

1 pikë

- A) Qëllimore
- B) Shkakore
- C) Rrjedhimore
- D) Kohore

24. Rishkruani si duhet nga ana e drejtshkrimit dhe pikësimit tekstin e dhënë më poshtë, duke nënvizuar qortimet që keni bërë.

3 pikë

Të tetën ditë, në atë qytet të vogël në juglindje të Shqipërisë, erdhën reparte ushtarake të rregullta të cilat, për dy vjet më radhë, qenë përpjekur të shuanin kryengritjen në Kosovë dhe në Shqipërinë e veriut. Të egërsuar nga luftimet, të pjestuar e të gjymtuar nga kryengritësit, kishin marrë rrugën e kthimit, duke shkuar drejt lindjes, përmes një toke armiqësore.

Mendoni për personazhin tuaj të preferuar, i cili do të jetë pjesë e kësaj pikturë dhe i shkruani një letër grupit drejtues ku të mbronit zgjedhjen tuaj.

6 pikë

11

[illegible]

Shtjellimi i idesë (25a)	Struktura (25b)	Stili dhe origjinaliteti (25c)	Saktësia gjuhësore (25d)	Totali
2	1	1	2	6 pikë